

# ELYSIUM

Nr. 8 Prishtinë, Mars 2007





Qendra për Këshillim dhe Testim Vullnetar - QKTV  
është në dispozicionin tuaj prej

**12:00 - 20:00**

**Nga e hëna deri të premten**

Rezultati i testit tuaj do të jetë **konfidencial**

**Vetëm ju dhe këshilltari do të dini rezultatin**

Testi i juaj do të jetë **anonim**

**Askush nuk do të di emrin tuaj**



## PËRMBAJTA

17 maji, dita ndërkombëtare kundër homofobisë.....	4
Britania e Madhe do të lejojë lezbikeve mbarsje artificiale. .	5
Gjyqi Brazilian e lejoi përvetësimin gej .....	5
Personat LGBT në Rusi kërcënohen me burg .....	6
Gej paradat 2007 nëpër Evropë.....	7
Kuptimi i çështjeve seksuale dhe këshillimi rreth tyre.....	8
Si bëjnë seks çiftet lezbiqe.....	9
Zhvillimi i identitetit dhe i identifikimit seksual.....	10
Homoseksualiteti në Shqipëri në shek. XIX.....	12
Freddie Mercury.....	13
Kabineti Italian shqyrton ligjin për bashkëjetesë civile....	14
Meksiko Siti miratoi ligjin për partnerët njëgjinorë .....	15
Çiftet gejë në Kolumbi fitojnë më shumë të drejta.....	16
Morrat Pubike .....	17
Zgjeba.....	18

# 17 Maji, Dita ndërkombëtare kundër homofobisë

Më 17 maj 1990, asambleja e përgjithshme e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e ka hequr homoseksualitetin nga lista e saj e çrrëgullimeve mendore.

Lufta për të njohur të drejtat e barabarta për personat gejë, lezbiqe, biseksualë dhe transgjinorë akoma nuk ka përfunduar.

Sot rreth 80 shtete të botës ende e kriminalizojnë homoseksualitetin dhe i dënojnë me burgim aktet seksuale me pëlqim të personave të gjinisë së njëjtë, nga këto 9 shtete (Afganistani, Irani, Mauritania, Nigeria, Pakistani, Arabia Saudite, Sudani, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Jemeni) ende e kanë dënimin me vdekje. Diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor ende nuk janë formalisht të njohura nga shtetet anëtare të OKB-së (edhe pse mekanizmat e të drejtave të njeriut siç është Komiteti i të drejtave të njeriut, i ka dënuar në mënyrë të vazhdueshme diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor).


ILGA luftoi kundër diskriminimin dhe njohjen e të drejtave të gejve, lezbiikeve, biseksualëve dhe transgjinorëve që nga themelimi i saj në vitin 1978. Kjo është edhe arsyaja pse ILGA është e zotuar fuqishëm për të kremtuar Ditën ndërkombëtare kundër homofobisë, që është kremtuar për herë të parë nga IDAHO (International Day Against Homophobia).

Në vitin 2005 IDAHO ka kremtuar në më shumë se 40 shtete, nga Franca deri në Hong Kong. Shumë iniciativa të

ndryshme janë ndërmarrë dhe u mbuluan gjérësisht nga mediat. Në Iran, për inat të homofobisë brutale të qeverisë, IDAHO ka folur për këtë në një numër të madh të ditarëve elektronik publik dhe në mijëra emra. Në Kiev, Ukrainë, u lëshua një balon i madh në të cilin shkruante "Thuaji jo homofobisë".

Të gjithë mund të kontribuojmë në kremitimin e ditës ndërkombëtare kundër homofobisë duke organizuar aheng, protestë apo ndonjë iniciativë tjetër që do të shtonte dukshmérinë në vendin tuaj.

Ju lutemi që të bartni mesazhin në çdo shtet të botës: 17 maji është Dita ndërkombëtare kundër homofobisë, është për homofobinë nga e cila ju duhet të frikësoheni, jo gejt!



## Britania e Madhe do të lejojë lezbiikeve mbarsje artificiale

Qeveria britanike është e gatshme që ta heq ligjin i cili kontrollon kush ka të drejtë për mbarsim artificial, që shfrytëzohet si pengesë lezbiikeve për të marrë fëmijë. Pritet që ndryshimi i ligjit të lajmërohet gjatë fjalimit hyrës të sesionit të ri parlamentar nga mbretëresha këtë javë.

Sipas ligjit të deritanishëm mjekët duhet të marrin parasysh "nevojën e fëmijëve për baba" kur të vendosin se a do t'i nënshtrohen femrat mbarsjes artificial apo jo.

Kjo formë shfrytëzohet për futjen e grave të pa



martuara e sidomos lezbiikeve.

Përfaqësuesi i qeverise britanike tha që kabinetit të Blerit iu është theksuar që kjo masë shkel aktin e të drejtave të njeriut dhe ligjin evropian për të drejtat e njeriut.

Grupet religioze konservatore janë kundër këtyre ndryshimeve.

"Heqja e këtij giesti simbolik ndaj rolit të babait është diskriminim ndaj meshkujve dhe për çështjen e mbarsjes korrekte" tha Josephine Quintavalle nga organizata Etika Produktive.

## Gjyqi brazilian e lejoi përvetësimin gej

Gjykatësi në São Paulo vërtetoi vendimin e gjyqit të ulët në të cilin lejohet përvetësimi i vajzës pesë vjeçare nga ana e një çifti gej. Njëri prej partnerëve, Vasco Pedro da Gama, sapo e ka përvetësuar një vajzë. Partneri i tij Dorival Pereira de Carvalho, kërkoi që në certifikatën e lindjes së vajzës të shënohet emri i tij si prind i dytë.

Në korrik gjyqi mori vendim se nuk ekziston asnjë arsy me vlerë për çiftet e gjinisë së njëjtë që të mos përvetësojnë fëmijë.


Dy çifte lezbiike më herët fituan të drejtën për përvetësim, kurse këtë të drejtë gjyqi nuk i lejoi çifteve gejë.

De Gama 33 dhe de Varvalho 41 vjeçar, pronarë të agjencisë për modele dhe sallonit të kozmetikës, qe 14 vite janë bashkë. Ky çift është takuar me

psikologë, punëtorë social dhe gjyqtarë publik para se të vinin para gjyqit me argumentin që Këshilli i Psikologëve të Brazilit lajmëron se "Homoseksualiteti nuk është sëmundje, as çregullim e as perversion".

Ky çift lajmëroi se kanë dëshirë të përvetësojnë edhe një vajzë prej 2 deri 4 vjeç.

Bashkësitë popullore njëgjinore në Brazil janë të lejuara në krahinën e Rio Grande do Sul. Grupet LGBT luftojnë që kjo e drejtë të zgjerohet edhe në pjesë tjera të vendit.



# Personat LGBT në Rusi kërcënohen me burg

Në Rusi mund të aprovohet ligji i cili përsëri do të kriminalizon homoseksualitetin.

Me këtë ligj do të ngritën dënimet me burg deri në pesë vite për se cilin që do të akuzohet si ushtrues i seksit të gjinisë së njëjtë.

Ligji i ri, i cili të hënën u prezantua në "Donjem domu", gati është i njëjtë me ligjin e Stalinit te vitit 1933, me të cilin homoseksualiteti dënohej me pesë vite punë të rënd.

Ligji i deputetit Nikola Kurjanoviqit përsëri do të jetës jo praktikën me të cilën të drejtat elementare të komunitetit gej, pikërisht takimet dhe parada do të janë të ndaluara.

Seksi ndërmjet personave të gjinisë së njëjtë është dekriminalizuar në vitin 1993, si rezultat i rënies së komunizmit, por gjatë viteve 1980, meshkujt gejë dhe lezbikut në formë rutine janë vendosur në spitale për shërim, ku janë detyruar të marrin barna.

Nuk është e qartë se deri do ta shtyjë propozim ligji i Kurjanoviqit, sepse nuk e përkrah asnjë parti. Megjithatë ligji e ka përkrahjen e komunistëve dhe Kishës ortodokse ruse.

Muajin e kaluar kryetari Rus akuzoi homoseksualitetin me murtajën e bardhë në Rusi, për deri sa kryetari i

Moskës, Lushkov ndaloi mbajtjen e paradës gej në Maj, duke i quajtur "djallëzore".

Aktivistët gejë Rus kanë ngritur padi kundër qytetit të Moskës për ndalimin e paradës gejë vitin e kaluar në Gjykatën evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg.

Në padi Moska akuzohet për thyerjen e të drejtave në lirinë e grumbullimit, e të drejtës në mbështetje gjyqësore dhe thyerjen e ligjit të diskriminimit nga Konventa evropiane e të drejtave të njeriut ku Rusia e ka nënshkruar.

Përkundër deklaratës së Lushkovlenit se paratad gejë "ndoshta janë të arsyeshme për shtetet perëndimore progresive, kurse për Rusin jo", ai përsëri vërteton se parada e vitit të kaluar është ndaluar për arsyen e sigurisë. Ai kërcënoi se do ta ndalojë paradën gej edhe këtë vit, e cila është caktuar përmuanin Maj 2007.

Grupet për të drejtat gej thanë se do të kundërshtojnë këtyre ndalesave, njësoj si vitin e kaluar.



# Gej paradat 2007

## nëpër Europë

<b>Qyteti</b>	<b>Shteti</b>	<b>Data</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Shteti</b>	<b>Data</b>
<b>Prill</b>			Londër	UK	30 Qershori
Krakow	Poloni	21 Prill	Lublanë	Sloveni	30 Qershori
Chisinau	Moldavi	27-29 Prill	Paris	Francë	30 Qershori
<b>Maj</b>			Vienë	Austri	30 Qershori
Bergen	Norvegji	28 Prill – 5 Maj	Zagreb	Kroaci	27 Qershori – 1 Korrik
BrukSEL	Belgikë	12 Maj	Augsburg	Gjermani	30 Qershori
Varshavë	Poloni	19 Maj	Trier	Gjermani	30 Qershori
Birmingham	UK	26-28 Maj	Oslo	Norvegji	22 Qershori – 1 Korrik
Moskë	Rusi	27 Maj	Madrid	Spanjë	22 Qershori – 1 Korrik
<b>Qershori</b>			<b>Korrik</b>		
Riga	Letoni	31 Maj – 3 Qershori	Budapest	Hungari	5-8 Korrik
Luksemburg	Luksemburg	2 Qershori	Porto	Portugali	7 Korrik
Nantes	Francë	2 Qershori	Köln	Gjermani	6-8 Korrik
Aberdeen	UK	2 Qershori	Oxford	UK	14 Korrik
Lille	Francë	2 Qershori	Leipzig	Gjermani	14-21 Korrik
Kiel	Gjermani	2 Qershori	Frankfurt	Gjermani	20-22 Korrik
Zürich	Zvicërr	1-3 Qershori	Stuttgart	Gjermani	21-29 Korrik
Bukuresht	Rumani	6-9 Qershori	Nottingham	UK	28 Korrik
Dresden	Gjermani	4-10 Qershori	<b>Gusht</b>		
Toulouse	Francë	8-29 Qershori	Belfast	Irlanda Veriore	28 Korrik – 4 Gusht
Strasbourg	Francë	16 Qershori	Hamburg	Gjermani	3-5 Gusht
Manchester	UK	16 Qershori	Nürnberg	Gjermani	3-5 Gusht
Düsseldorf	Gjermani	16-17 Qershori	Amsterdam	Holandë	3-5 Gusht
Berlin	Gjermani	16-24 Qershori	Stockholm	Suedi	30 Korrik – 5 Gusht
Dublim	Irlandë	8-24 Qershori	Reykjavik	Islandë	9-12 Gusht
Athinë	Greqi	23 Qershori	München	Gjermani	11-12 Gusht
Lisbonë	Portugali	23 Qershori	Kopenhangë	Danimarkë	18-26 Gusht
Marseille	Francë	23 Qershori	Dortmund	Gjermani	25 Gusht
Edinburgh	UK	23 Qershori	Manchester	UK	17-27 Gusht
Lyon	Francë	15-28 Qershori	<b>Shtator</b>		
Helsinki	Finlandë	25 Qershori – 1 Korrik	Cardiff	UK	1 Shtator

# Kuptimi i çështjeve seksuale dhe këshillimi rreth tyre

Historikisht, kujdesi shëndetësor që iu është ofruar minoritetëve seksuale, ka qenë më se i pamjaftueshmëm, pjesërish për shkak se ofruesit e kujdesit shëndetësor nuk kanë qenë të edukuar sa duhet për ta fituar një kuptim të drejtë të çështjeve të orientimit seksual; pjesërish për shkak të qëndrimeve negative të mjekut ndaj homoseksualitetit; dhe pjesërish për shkak se deri në vitin 1970, shqetësimet e lezbiikeve, gejëve dhe të biseksualëve kanë qenë të fshehura dhe nuk janë kuptuar si duhet.

Ky kapitull fillon me rishqyrtimin e informacioneve të prapaskenës që të gjithë profesionistët shëndetësorë duhet t'i dinë sa i përket orientimit seksual, pastaj vazhdon me ekzaminimin e çështjeve specifike shëndetësore që kanë të bëjnë me orientimin seksual.

## Historia e qëndrimeve mjekësore ndaj homoseksualitetit

Ata pacientë, të cilët u tregojnë mjekut të tyre që janë gejë ose biseksualë do ta bëjnë këtë për një mori arsyesh; për shembull: dëshirojnë të diskutojnë përkëtë fushë me qëllim që të fitojnë këshillim Seksual, pastaj besojnë se këto informacione do ta ndihmojnë menaxhimin mjekësor, ose thjesht sepse janë "homoseksualë publik" dhe

dëshirojnë të janë të rëndësishëm në aspektin demografik - njëjtë sikurse pacientët heteroseksualë që mund ta përmendin se janë të martuar.

Megjithatë, tendenca për të qenë homoseksual publik te profesionistët mjekësorë (në mes tjerash) është fenomen social relativisht i ri. Një gjë e tillë është nxitur nga lëvizjet e paradave të gejeve në vitet e 70-ta dhe është bërë e nevojshme për meshkujt gejë dhe femrat lezbiike për shkak të HIV-it në vitet e 80-ta dhe të 90-ta.



Në vitin 1980, Dardick dhe Grady zbuluan se në SHBA më pak se 50% e meshkujve gejë që kanë dalë publik u kanë treguar ofruesve të tyre të kujdesit primar shëndetësor që janë gejë. Dikush mund të hamendet se përat a homoseksualë të

fshehtë, shifrat kanë qenë më të vogla. Në Australi, mbi 20% e meshkujve homoseksualë që kanë manifestuar infeksione seksualisht të transmetuara nuk i kanë treguar mjekut personal, se infeksioni i tyre është fituar nëpërmjet marrëdhënieve homoseksuale.

Fatkeqësish, njëra prej arsyeve përkëtë është se  $\frac{1}{4}$  e mostrës prej 1000 mjekëve ka pranuar se me të kuptuar se pacienti është homoseksual, dëmshëm do të ndikonte në menaxhimin e tij mjekësor. Në vitin 1980, 84% e mjekëve amerikan

të anketuar janë pajtuar se pacientët homoseksualë ngurrojnë që ta kërkojnë ndihmën mjekësore, për shkak të mosmiratimit të mjekut.

Në vitin 1981, Davison dhe Friedman kanë zbuluar se kur dy grupeve të psikologëve u është dhënë historia e një mashkulli, dhe njëri prej këtyre grupeve u është thënë qëllimi që se pacienti është homoseksual, shumica e problemeve të pacientit nga grupi i tillë kanë qenë të konstruktuara në kuptimin seksual dhe në aspektin seksual është përqendruar më së shumti. Duket se paragjykimet emocionale, zakonisht të aktivizuara nga mungesa e informacioneve të besueshme, ka pasur ndikim të dëmshëm si në trajtim ashtu edhe në këshillim të pacientit. Andaj, së paku gjë

më tani, qëndrimi negativ i mjekut ndaj homoseksualitetit duket të ketë ndikuar negativisht në ndihmën e ofruar mjekësore personave homoseksualë. Shilts e identifikon këtë ndikim negativ të m j e k u t n d a j homoseksuositetit si një nga disa faktorët që i parandalojnë profesionistët shëndetësorë nga përgjigja ndaj epidemisë së AIDS-it. Neglizhenca e tillë fajësuese e mjekut duke "vënë benzinë në zjarr" në një epidemi nuk guxon të lejohet më të ndodhë.



## Si bëjnë seks çiftet lezbike

Janë shumë mënyra që gejët dhe lezbiket mund të bëjnë seks me partnerët e tyre. Këtu përfshihen: puthjet, masturbimi, masazhet erotike, fërkimi i trupit, fantazia dhe përdorimi i lodrave seksuale për stimulim, anal, vaginal dhe të klitorisit.

Këto lloje të lodrave seksuale ndryshe quhen edhe "outercourse". Gjithashtu shumë njerëz e pëlqejnë seksin oral.

Çdokush është i ndryshëm kur vjen në shprehje kënaqësia seksuale. Njerëzit kanë dëshira të ndryshme dhe vetëm ju mund ta dini se kur ndjeheni mirë.

Lezbiket nuk kanë nevojë të brengosen rreth shtatzënësisë përderisa bëjnë seks me femra tjera, por brengosen për ta mbrojtur veten kundër infekcioneve seksualishët të transmetuara. Megjithëse,

përqindjet e transmetimit janë të vogla për femrat që kanë seks me femra, megjithatë ka mundësi që lezbiket të infektohen dhe të bartin infekzionin.

Lezbiket mund të zgogëlojnë rezikun për infektim në të njëjtën mënyrë sikurse edhe heteroseksualët, nëpërmjet seksit të sigurt, duke përfshirë sjelljet me rezik të ulët dhe duke përdorur barrierat e lateksit, siç janë prezervativët, dorëzat dhe barrierat tjera me material nga lateksi.



# Zhvillimi i identitetit dhe i identifikimit seksual

Identiteti dhe përshtatja janë seksuale nuk zhillohen në një vakum, por marrin formë nga kuptimet familjare, sociale dhe kulturore të asaj se çka nënkuption tërheqja ndaj gjinisë së njëjtë dhe gjinisë së kundërt. Coleman dhe Cass i kanë propozuar shembujt e zhvillimit të identitetit homoseksual që do të mund t'i ndihmonin profesionistëve në vlerësimin dhe kuptimin e stadeve të të dalit publik ndaj vetveteve të homoseksualitetit. Që të dy modelet e theksojnë nevojen për qeniet njerëzore që të zhillohen; me qëllim që ta identifikojnë orientimin seksual dominues; t'i zgjedhin komplikimet intrapsikike, interpersonale dhe ato sociale të identitetit të tyre të orientimit dhe ta integrojnë seksualitetin e tyre në kuptimin më të gjerë të vetes përfunksionim të shëndetshëm seksual dhe mental. Dështimi në zgjidhjen e dilemave dhe të pyetjeve rreth orientimit paraqet rrezikun për shpirje deri tek infantilizmi i seksualitetit ose kthimi në një stad të mëhershëm të shoqëruar me shqetësim psikik dhe ndikim afatgjatë negativ në shëndetin mental.

Teoria e pjekurisë e kombinuar me studimet psikologjike të cituara më lartë, sugjerojnë se shumë, nëse jo shumica, njerëz i zgjidhni dyshimet rreth orientimit të tyre seksual duke u identifikuar si homoseksualë-gejë, heteroseksualë dhe disa si biseksualë, edhe pse




atrakcionet dhe dëshirat e tyre të brendshme janë më komplekse sesa që këto emërtime përkruajnë. Si modeli i Coleman-it ashtu edhe i Cass-it e theksojnë rëndësinë që pranimi dhe përjetimi i orientimit seksual në mënyrë pozitive ka për shëndetin mental të njerëzve.

Modeli i Cass-it parashtron 6 stade të zhvillimit të identitetit homoseksual te një individ.

## 1. Konfuzioni i identitetit

2. Krahasimi i identitetit
3. Toleranca e identitetit
4. Pranimi i identitetit
5. Krenaria për identitetin
6. Sinteza e identitetit

Konfuzioni i identitetit paraqet fazën kur individët ndihen se janë ndryshe nga të tjerët dhe se ndjenjat ose sjellja e tyre mund të emërhohet si homoseksuale. Stadi i dytë, krahasimi i identitetit, është kur individët e bëjnë përkushtimin e parë ngurrues ndaj identitetit homoseksual dhe realizimit të të genit homoseksual deri në njëfarë shkallë.



Me tolerancën e identitetit tek individi vjen deri te njohja se ai ose ajo ndoshta është homoseksual dhe paraqitet një shkallë zotimi ndaj këtij identitetit. Në stadin katërt, stadin e pranimit të identitetit, individi e pranon emërtimin si homoseksual, së paku në shoqerinë gej dhe fillon

të shoqërizohet brenda nën kulturës gej. Stadi i krenarisë së identitetit shënohet me hapje të gjerë dhe aktivitet të hapur dhe e përshkruajnë gjendjen ku çdo gjë që individi bën, definohet pikë së pari nga homoseksualiteti i tij ose i saj. Në këtë stadi, identiteti qendror i personit është si homoseksual.

Stadi i gjashtë i modelit të Cass-it është ndoshta njëri që ka stimuluar më së shumti debate. Tek individi, qëndrimi i homoseksualëve "ata kundër neve" zbehet dhe zëvendësohet me një gjendje kur identiteti homoseksual i personit shikohet si të qenët një seri e identiteteve, por jo një që i definon të gjitha aspektet e jetës së personit. Individ, me këtë, mund ta sheh se të jesh homoseksual është një çështje e rastësishme si një besim politik ose profesion dhe jo si diçka që ai ose ajo është gjatë tërë kohës. Është me rëndësi që seksualitetin e pacientëve ta trajtojmë varësisht nga niveli i pranimit në të cilin ndodhen dhe jo të mundohemi t'i shtyjmë shumë shpejtë në këto stade. Duhet t'i lejojmë t'i arrijnë këto stade me kurajë, në ritmin e tyre.

Coleman-i, gjithashtu, i ka përshkuar stadet e formimit të identitetit homoseksual.

Stadet e tij janë sic vijon:

1. Para të dalit publik
2. Të dalët publik
3. Gjurmimi dhe eksperimentimi
4. Lidhja e parë
5. Integrimi

Secili stadi procesit të të dalit publik paraqet sfida të veçanta shëndetësore si për ofruesin e ndihmës shëndetësore ashtu edhe për pacientin. Duke i shfrytëzuar stadet e të dalit publik të Coleman-it, Rosser-i ka identifikuar çështjet klinike të shoqëruara me secilin stadi të procesit. Gjatë stadit të parë, para të dalit publik, aspekti mbizotërues klinik

është shqetësimi për orientimin. Pacienti mund të jetë i demoralizuar rëndë madje edhe suicidal. Gjatë të dalit publik, shfaqen dhe dominojnë konflikte interpsikike dhe interpersonale. Gjatë stadiit të tretë të Coleman-it, eksplorimit, është me rëndësi që ofruesi i ndihmës ta miratojë eksplorimin e seksualitetit të personit, si sfidë që duhet adresuar, janë çështjet e sigurisë përfshirë këtu edhe këshillimin për seks më të sigurt. Pas këtij stadi, lidhjet e para paraqiten si preokupim qendror i pacientit. Këtu janë të spikatura aspektet klinike të varshmërisë, të izolimit dhe mosrespektimit të udhë rrëfimeve për seks më të sigurt. Me të arritur integrimin, shqetësimet kryesore klinike vështirë se më mund t'i referohen orientimit seksual të personit, përvèç në situatat e stresit ose të traumës. Në situatat e tillë, shqetësim kryesor klinik bëhet regresioni në stadet e mëhershme të konflikteve.



# Homo~~s~~eksualiteti në Shqipëri në shek. XIX

Praktika e homoseksualitetit në Shqipëri ka një histori të gjatë dhe ka vazhduar në shekullin XIX. Hahn, në kursin e librit të tij *Albanische Studien* ka thënë që djemtë e rinj të moshës 16 deri 24 kanë joshur djemtë e moshave prej 12 deri 17 vjeç.

Në literaturë dashnori apo *eromenosi* është quajtur *ashik* (nga arabishtja *ishq* që do të thotë "dashuri e pasionuar") dhe i dashuri apo *erastesi* është quajtur *dylber* (nga turqishtja *dilber* që do të thotë "i bukur"). Një gegë i martuar në moshën 24 apo 25 vjeç, zakonisht por jo gjithmonë ka hequr dorë nga dashuria për një djalë. Paragrafi i mëposhtëm është raportuar nga Hahn si gjuhë aktuale e përdorur tek ai nga një gegë shqiptar:

*Ndjenja e dashnorit për një djalë është e dëlirë sikur rrezja e diellit. Kjo e vendos të dashurin në piedestalin e njëjtë sikur të shenjtin. Është pasioni më i lartë dhe më madhështor për të cilën zemra e njeriut ka aftësi. Pamja e rinisë së bukur ngjall mahnitje te dashnori dhe hap derën e zemrës së tij për adhurimin, të cilin e lejon soditja e kësaj dashurie. Dashuria merr në tërësi zotimin e tij, saqë gjithë mendimi dhe ndjenjat e tij shkojnë jashtë tij. Nëse e gjen veten në prani të të dashurit, ai pushon duke absorbuar dhe duke e shikuar në sy atë. I hutuar, ai nuk mendon asgjë tjeter përvëç tij. Nëse i dashuri paraqitet në mënyrë të paparaçhkuar ai hutohet, ndryshon ngjyrat herë bëhet i zbehtë e herë i kuq. Zemra e tij rreh më shpejtë dhe pengon frysëmarrjen e tij. Ai i ka veshët dhe sytë vetëm për të dashurin. Ai shmanq prekjen e tij me dorë, e puth atë vetëm në ballë, i thur lëvdata në vargje, që përfshirë kjo nuk ndodhë kurrë.*

Një nga këto poema të dashurisë të një shqiptari gegë është si në vijim:

*"Dielli, kur lind në mëngjes, është sikurti, djalë, kur je afër meje. Kur syri yt i zi më shikon mua, e heq arsyen nga koka ime."*



Duhet shtuar se profesori Weigand, i cili i njihet shumë mirë shqiptarët, e ka siguruar Bethe (Rheinisches Museum für Philologie, 1907) që lidhjet e përshkruara nga Hahn janë vërtetë seksuale edhe pse me karakter të idealizmit. Shkollari gjerman, i cili ka udhëtuar nëpër Shqipëri disa vite më herët, gjithashtu e ka siguruar Näcke (Jahrbuch für sexuelle Zwischenstufen, 1908) se ai plotësish mund të konfirmojë pohimet e Hahn-it edhe pse ishte e vështirë të flitet pozitivisht, ai dyshonte që këto lidhje ishin plotësish ideale. Edhe pse shumë e shpeshtë në mesin e shqiptarëve mysliman, këto gjithashtu u gjetën edhe të shqiptarët e krishterë dhe kishin bekimin e priftit në kishë, në një ceremoni të rjobur si *vëllamëria* (nga gjuhja shqipe *vëlla* dhe *marr*), ngjashëm me grekët *adelphopoia* ("krizimi i vëllazërisë"). I njëjtë shkrimitar shkruan: shumë shpesh ngjalët xhelozia dhe mund të shkaktohej edhe vrasja për shkak të një djali. (Havelock Ellis, Studies in the Psychology of Sex, Sexual Inversion).

# Këngëtari i grupit "Queen", Freddie Mercury

5 shtator 1946 - 24 nëntor 1991

Freddie Mercury u lind me emrin Farrokh Bulsara në ishullin e Tanzanisë, Zanzibar.

Për herë të parë Mercury mësoi të luante në piano në Indi, në shkollën Shën Pjetri. Në vitin 1964 kur ishte 17 vjeç, Revolucioni i Zanzibarit e detyroi atë dhe familjen e tij që të shkojnë në Angli. Atje ai diplomoi në art dhe dizajn grafik në kolegjin "Ealing Art". Më vonë ai e përdori talentin e tij për të dizajnuar shenjën e grupit të famshëm "Queen".

**"Frontmeni" i "Queen":**  
Këngëtar, shkrues i vargjeve, pianist dhe vokalist, Freddie Mercury ishte "frontmeni" më i famshëm i grupit britanez "Queen" i famshëm për këngët "Bohemian Rhapsody", "Crazy Little Thing Called Love" dhe "We Are the Champions".

**Freddie Mercury gjë:** Freddie Mercury kishte një lidhje me një grua, Mary Austin, pavarësisht nga orientimi tij seksual. Freddie Mercury doli publik më 12 mars të viti 1974 në një intervistë në *New Musical Express*. Ai tha për revistës muzikore, "Unë jam aq gjë sa edhe narcisi i egër". Ai jetoi me partnerin e tij të fundit, Jim Hutton, për gjashtë vjet.

**Freddie Mercury dhe AIDS-i:** Mercury u diagnostikua me AIDS në vitin 1987, por ai e mohoi publikisht këtë deri një ditë para vdekjes së tij, në nëntor të viti 1991. Mercury vdiq nga pneumonia bronkiale

për shkak të komplikimeve të AIDS-it. Ai ishte 45 vjeç.



## Faktet për Freddie Mercury-in:

Vokali i Mercury-it shtrihej në katër oktava;

Mercury asnjëherë nuk kishte pasur trajnime të mëhershme për vokalin;

Mercury u rendit në vendin e dytë në listën e MTV-së, ndër 22 këngëtarëve më të mirë të 25 viteve të fundit;

Mercury ishte përmendur në shënimet e Kurt Cobain para se të bënte vetëvrasje;

Mbetjet e hirit të Freddie Mercuryt nuk dihen se ku janë;

Mercury ia la pasurinë e tij shoqes së tij Mary Austin;

Mercury vdiq në të njëjtën ditë kur vdiq edhe bateristi i grupit KISS, Eric Carr.

**Lajmet më të fundit për Freddie Mercury-in:** Më 25 gusht 2006 një grup i quajtur Shoqata e Zanzibarit për propagandimin dhe mobilizimin e Islamit, kërkoi nga ministria e kulturës të Zanzibarit që të ndalojë ahengun e planifikuar në plazh për të nderuar ditëlindjen e gjashtëdhjetë të Freddie Mercury-it. Grupi konsideron se "stili i jetës" së Mercury-it ishte pompoz dhe ofendues për popullatën myslimane të Zanzibarit.

# Kabineti italian shqyrton ligjin për bashkëjetesë civile

Kabineti i kryeministrit italian Romano Prodi, të enjten ka aprovuar ligjin e krijimit të bashkësive civile për çiftet gejë dhe lezbiqe.

Pritet që ligji t'i prezantohet parlamentit më së voni gjatë këtij muajti, vetëm se përvetësimi i tij është pezull. Koalicioni i majtë i Prodit ka një shumicë të vogël, kurse opozita e djathë e kryesuar nga Silvio Berlusconi e bashkuar me Vatikanin janë kundër këtyre masave.

Vlerësohet arrije e madhe edhe fakti që Prodi siguroi aprovimin e kabinetit. Qeveria e tij, të cilën e përbëjnë koalicioni i nëntë partive të vogla, ka disa muaj që diskutojnë rreth bashkësive civile. Komunistët bëjnë shtypje që të lejohen të gjitha të drejtat bashkëshortore, deri sa partia UDEUR kundërshton të gjitha legalizimet.

Disa anëtar të kësaj partie kanë paralajmëruar se do të votojnë kundër këtij ligji në parlament, me qëllim të rënies së qeverisë.

Ligji i bashkëjetesës civile nuk është aq i gjatë sikur ligji Britanik, i cili njeh të gjitha të drejtat bashkëshortore vetëm që nuk është i emëruar, por konsiderohet si i njëjtë me ligjin francez i cili çifteve njëgjinorë iu jep të drejta të kufizuara.

Ky ligje do t'i lejojë të shënohen në regjistër dhe t'i ndahen pensione, sigurime shëndetësore, të nënshkruan në marrëveshje dhe do t'i barazon me çiftet e martuar rreth amvisërisë.

Senati italian në dhjetor ka dhënë propozim ku nga qeveria pritet që deri në fund të janarit të arrihet ligji. Propozimi u dha një ditë pasi që në qytetin verior Padui u vendos të bëhet regjistri i



amvisërive njëgjinore dhe çifteve heteroseksuale të pakurorëzuara.

Më vonë Senati i lejoj qeverisë zgjatjen e afatit, por Vatikani ka kundërshtuar dhe cenuar ligjin.

Papa Benedekti XVI muajin e kaluar tërroqi vërejtjen krijuesve të ligjit se do t'i përdor të gjitha format për të ndikuar në ngadalësimin e planifikimit të legjislacionit për krijimin e bashkëjetesave civile.

Projektet të cilat lejojnë para kohe pranimin e bashkësive (të cilat janë ndryshe nga ato tradicionale) kanë ndikim të rrezikshëm dhe kundër produktiv, sepse me këtë dobësøjë dhe destabilizojnë ligjet e krijuara në martesë, deklaroit një peshkop në mbledhjen e drejtuesve të të gjitha kishave lokale të tërë Italisë.

Prodi përkrah të drejtat e arsyeshme për çiftet njëgjinorë prej vitit 2005, që kur ka pasur takim me aktivistët gejë, por kundërshton martesat gejë.

Pesë kandidat LGBT janë zgjedhur të janë në parlamentin italian, të gjithë janë pjesë e së majtës qendrore, duke përfshirë edhe personin e parë transeksual në Parlament.

# Meksiko Siti miratoi ligjin për parterët njëgjinorë

Ligji i cili njeh të drejtat popullore për çiftet gejë-lezbiqe në kryeqytetin Meksikan është lajmëruar në listë zyrtarisht me 14 nëntor, dhe ky është një ndër ligjet e para të këtij lloji në historinë e një shteti pro katolik konservator.

Ligji nuk lejon martesat gejë-lezbiqe, por iu lejon çifteve njëgjinorë të cilët jetojnë në Meksiko Siti të regjistrohen zyrtarisht dhe t'i shfrytëzojnë të drejtat e trashëgimisë si të gjithë bashkëshortët/et.

Kryetari i qytetit Alejandro Encinas e ka firmosur këtë ligj, por ai do të hypë në fuqi mbas 120 ditëve. Vetëm një organizate joqeveritare konservatore shprehi pa kënaqësi dhe ngriti padi gjyqësore kundër këtij ligji. Ligjin disa herë e kanë kritikuar kisha katolike dhe grupet konservatore të këtij vendi që është i banuar më se 90% me popullatë të besimit katolik. Peshkopi i Meksiko Sitis

theksoi se ky ligi është hap i parë ka legalizimi i martesave gejë dhe përvetësimi i fëmijëve nga ana e personave LGBT ku homoseksualiteti ende në shumë vende rurale të Amerikës jugore është temë tabu, për kundër zonave urbane të këtij regjioni që janë më tolerante.

Përveç Meksiko Sitis në këtë drejtim legalizimin e çifteve njëgjinorë e kanë bërë edhe kryeqyteti i Argjentinës (Buenos Aires) dhe shteti jugor Brazili, Rio Grande do Sul. Në kuadër shtetëror ligjvënësit e Kosta Rikos dhe Kolumbisë e kanë shqyrtuar këtë çështje, por ende nuk është miratuar ligji.

Parlamenti i Meksiko Sitis e ka miratuar këtë ligj me 43 vota pro dhe 17 kundër, të gjitha votat kundër kanë ardhur nga partia konservatore e cila është e njohur me kundërshtimet kundër abortit dhe përkrahëse e fortë familjeve tradicionale.



# Çiftet gejë në Kolumbi fitojnë më shumë të drejta


Çiftet njëgjinorë në Kolumbi kanë filluar të fitojnë përkrahje.

Gjykata kushtetuese e këtij shteti jug amerikan ka sjellë vendim që çiftet gejë dhe lezbike duhet të fitojnë të drejta për patundshmëri të njëjta sikur heteroseksualët.

Gjykata ka ndryshuar definicionin legal për çiftet e pamartuar, sepse ligji i vitit 1990, i cili ju jep të drejtë patundshmërisë sipas pronarit të tokës dhe trashëgimisë pas vdekjes së një partneri/e, i dedikohej vetëm "burrit ose gruas"

Gjykata me vëmendje vë në pah se ky vendim automatikisht nuk jep të drejtën për formimin e bashkësive bashkëshortore. Parlamenti Kolumbian momentalisht shqyrton ligjin me të cilin çifteve njëgjinorë do ti mundësohet regjistrimi dhe dhënia e shumë të drejtave të cilat i kanë bashkësitetë bashkëshortore.

Megjithatë, aktivistët këtë vendim e përjetojnë si hap të madh përparrë, i cili do të ketë ndikim në afro 100.000 çifte njëgjinorë.



Gjykata theksoi se ligji duhet të jetë neutral ndaj gjinisë.

Sipas ligjit, çiftët njëgjinorë të cilët kanë dëshirë ta ndajnë pasurin është dashur të hapnin kompani, në emrin e të cilit duhet të jetë pasuria, sikur edhe ta bind ndarjen e pasurisë sipas kompanisë. Në fakt edhe atëherë nuk ka qenë plotësisht e garantuar që mbas vdekjes së njëjrit partner/e pasuria ti takoi atij/asaj që është gjallë.

Megjithatë, theksojnë se Kolumbisë i nevojiten më shumë këso lloj ligje për barazi.

"Ligjet nuk janë të mjauftueshme, nevojitet ndryshimi i kulturës ... për ta ndaluar diskriminimin", tha Marcela Sanqez nga Grupi LGBT Colombia Diversa.

Kisha katolike kundërshton ligjin e ri dhe vendimin e gjykatës e quan si "Kundërfamiljar"

# Infekzionet seksualisht të transmetuara - IST

## Morrat Pubike

### Çka është Pedikuloza gjenitale?

Pedikuloza gjenitale është infeksion i shkaktuar nga parazitët - Morrat pubik - që kapan për qimet pubike dhe në qimet e tjera të trupit.

Për të mbijetuar këta morra iu nevojitet gjaku por ata mund të mbijetojnë deri në 24 orë jashtë trupit të njeriut.

Morrat pubik i kanë tri fazë të zhvillimit:

- Faza e parë janë vezë ose thërija;
- Faza e dyte është morri në zhvillim;
- Faza e tretë morri i rritur;

### Sitranstmetohen Morrat pubik?

Ka dy forma të transmetimit: seksual dhe joseksual.

Transmetimi seksual:

Ju mund t'i merrni morrat, sa herë që pjesët e trupit tuaj të cilat janë të mbuluara me qime, siç është sipërfaqja pubike, vetullat, mjekra, gjoksi edhe nën sjetullat, vijnë në kontakt me qimet e mbushur me morra. Morrat pubik nuk kapan në flokë.

Transmetimi joseksual:

Gjatë transmetimit joseksual ju mund t'i merrni morrat edhe nëse:

- Flini në një shtrat të mbushur me

morra dhe nëse përdorni peshqirë të mbushur me morra;

- Visheni me rroba që janë të mbushura me morra;
- Në raste të rralla ju mund të mbusheni me morra edhe nga ulëset e tualetit;

### Cilat janë simptomat e Morrate pubik?


- Simptoma më e zakonshme është kruarja në pjesët pubike. Kjo komë vjen si shkak i reaksionit alergjik nga kafshimi i morrave dhe përafërsisht fillon pesë ditë pas mbushjes me morra;
- Morrat janë parazitë të vegjël por ju mund t'i shihni edhe me sy për së afërm;
- Si rezultat i kafshimeve në pjesët ku morrat ekzistojnë, paraqiten pika të mavijosura të kaltra, të cilat zgjasin disa ditë;

### Diagnostikimi i Morrave pubik?

- Zakonisht ju mund t'i shihni ato nëse i shikoni për së afërm;
- Nëse nuk jeni të sigurt vizitonit mjekun;

### Si trajtohen Morrat pubik?

Ekzistojnë krema dhe shampone për tretman të Morrave pubik. Ju këshillojmë që këto krema dhe shampone t'i merrni vetëm me




rekomandim tē mjekut.

Edhe nëse trajtimi është i suksesshëm ju mund tē keni akoma kromë si shkaki iritimt tē lëkurës.

### Çfarë duhet tē dimë tjetër që mos tē mbushemi me Morra pubik?

- Edhe pas trajtimit shumë thërija mbesin në qime por ju mund t'i largoni me brusha dhe krehër;
- Pas trajtimit, gjithnjë tē vishni rrobe tē pastra dhe flini në shtretër tē pastër;
- Njoftoni partnerët tuaj seksual që tē trajtohen edhe ata;
- Abstenoni nga seksi deri sa ju dhe partnerët tuaj tē p a s t r o h e n i plotësisht;
- Edhe pas trajtimit



rrobat dhe shtrati juaj mund tē jetë akoma i mbushur me morra. Që t'i largoni morrat ju duhet që t'i lani tē gjitha rrobat dhe shtratin tuaj në ujë me temperaturë mbi 60 gradë celsius dhe tē thahen mirë;

- Nëse trajtimi nuk ka pasur sukses ju duhet që përsëri ta kontaktoni mjekun;

### Si duhet tē vepojmë që tē mos mbushemi me Morra pubik?

- Abstenimi nga seksi;
- Marrëdhënia seksuale vetëm me një partner, i cili bën seks vetëm me juve;

Përdorimi i kondomëve nuk ndihmon në mbrojtjen kundër morrave. Kondomët janë e f e k t i v në parandalimin e infeksioneve tjetra seksuale.

## Zgjeba

### Çka është Zgjeba?

Zgjeba është infektim i lëkurës e shkaktuar nga paraziti Sarcoptes Scabiei. Disa orë pas infeksionit paraziti femëror vendoset nën lëkurë dhe i lëshon vezët dy deri në tri vezë në ditë, përafërsisht pas dhjetë ditësh nga këtë vezë krijohen parazitët e rinj, dhe ky cikël vazhdon duku u përsëritur.

Paraziti i zgjebes jashtë trupit tē njeriut mund tē jetojë prej 48 deri në 72 orë. Ndërsa në trupin e njeriut paraziti femër mund tē jetojë deri në një muaj.

### Si transmetohet Zgjeba?

Zgjeba mund tē transmetohet në mënyrë seksuale dhe joseksuale.

Mënyra seksuale:

Mënyra seksuale e transmetimit bëhet nëpërmjet kontaktit fizik. Transmetimi mund tē ndodhë më lehtë nëse partnerët e kalojnë natën sëbashku sesa një marrëdhënie seksuale e shkurtër.

Mënyra joseksuale:

Nuk është i nevojshëm kontakti seksual

që Zgjeba të përhapet, transmetimi mund të ndodhë edhe nëpërmjet kontaktit me: shtrojën e shtratit (çarçafët, mbulesa e jastëkut, jorgani, batanijet etj), me mobilet (kauqi, kolltuku, karrigia, divani etj).

Zgjeba nuk mund të transmetohet nëpërmjet: përqafimeve, shtrëngimit të dorës ose me objektet siç është ulësja e tualetit.

### Kur paraqiten simptomat?

Nëse personi është infektuar për herë të parë, simptomat paraqiten përafersisht katër deri gjashtë javë pas infekzionit. Nëqoftëse personi ka qenë më parë i infektuar me zgjebë, simptomat do të paraqiten prej një deri katër ditë pas infekzionit.

### Cilat janë simtomat e Zgjebes?

- Kroma e pandërprerë që zakonisht gjatë natës bëhet me e ashpër;
- Formimi i shtrofullës së parazitëve

zakonisht në formë të shkronjës "S";

- Paraqitja e dëmtimeve siç janë: gungat me ngjyrë të mbyllët, puçrrat dhe shpërthimi i tyre;

Sipërfaqet më të zakonshme të paraqites janë:


Hapsirat në mes të gishterinjeve, sipërfaqet pubike, nën sqetullat, bërrylat, gjunjët, pjesa e poshtme e vitheve, penisi, bishti, pjesa e barkut etj.

### Si diagnostikohet Zgjeba?

Ekzistojnë metoda të ndryshme të diagnostikimit. Nëse dyshoni se e keni zgjebën menjëherë lajmërohuni te mjeku përkates.

### Si trajtohet Zgjeba?

Egzistojnë krema të ndryshme për trajtimin e Zgjebes. Ju këshillojmë që këto krema t'i merrni vetëm me rekomandim të mjekut.



© 2004 MERKEZI I ZDRAVSTVA

**Shoqata “Elysium”** është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2002 me synim për të punuar intensivisht në fushën e të drejtave të komunitetit gej në Kosovë, duke besuar se në një shoqëri demokratike janë të domosdoshme të gjitha alternativat që japid kontributin e tyre në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Syntimet kryesore të shoqatës janë:

- Forcimi dhe ngritja e vetëbesimit në komunitetin gej;
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komunitetit gej;
- Krijimi i rrethit tolerues në shoqërinë tonë;
- Lobimi me OJQ-të e tjera për të plotësuar ligjet kundër diskriminimit të bazuara në Konventat Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut;
- Monitorimi i institucioneve ligue dhe gjyqësore në aplikimin e ligueve kundër diskriminimit të aplikuara në Kosovë;
- Përkrahje dhe këshillim për personat gejë;
- Sensibilizimi dhe dhënia e informatave të drejta për personat gejë te popullata e përgjithshme e Kosovës nëpërmjet mediumeve të ndryshme të informimit;

**Botues:**

**Shoqata “Elysium”**



[elysium@gaykosova.org](mailto:elysium@gaykosova.org)

[www.gaykosova.org](http://www.gaykosova.org)

**Financuar nga:**



SWEDISH INTERNATIONAL DEVELOPMENT  
COOPERATION AGENCY

